BASHKIA
TIRANË

KRYETARI

URDHËRESË

Nr. 33558, datë 18.9.2017

MBI ORGANIZIMIN E PLANIT TË LËVIZJES SË AUTOMJETEVE GJATË MBARËVAJTJES DHE ORGANIZIMIT TË "GARËS ME BICIKLETA ME NXËNËSIT E GJIMNAZEVE TË TIRANËS" NGA MINISTRIA E MJEDISIT NË KUADËR TË "JAVËS EUROPIANE TË LËVIZSHMËRISË

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, nënpika 1.1, shkronja "b", nenit 25 dhe nenit 64 shkronja "a" të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; nenit 3, pika 30, nenit 5, pika 3, nenit 7, pikat 1, dhe nenit 37 të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar); vendimit nr.153, datë 07.04.2000 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar) si dhe në kuadër të nismës ndërkombëtare të Bashkimit Europian "Java Europiane e Mobilitetit" dhe ndërgjegjësimit të komunitetit mbi reduktimin e përdorimit të makinave private dhe promovimin e alternativave mjedisore në transport, si dhe mbarëvajtjen dhe organizimin e aktiviteteve kulturore me rastin e "Garës me bicikleta me nxënësit e gjmnazeve të Tiranës",

URDHËROJ:

1. Kufizimin e qarkullimit të automjeteve në datën 20 Shtator nga ora 11:00 deri në orën 13:00 në rrugën "Lekë Dukagjini", në Sheshin "Nënë Tereza" dhe përgjatë segmentit të bulevardit "Dëshmorët e Kombit" deri në kryqëzimin me rrugën "Abdyl Frashëri", në të dy senset e lëvizjes.

2. Qarkullimi i automjeteve, mjeteve të emergjencës dhe Policisë së Shtetit do të bëhet, sipas planit të lëvizjes më poshtë:

- Në kryqëzimin e rrugës "Ibrahim Rugova" (sipas sensit Veri-Jug) me rrugën "Lekë Dukagjini", drejtim i detyruar drejt, me drejtim lëvizje në rrugën "Adem Jashari" dhe anasjelltas;
- Në kryqëzimin e bulevardit "Dëshmorët e Kombit" (sipas sensit Veri-Jug) me rrugët "Abdyl Frashëri" dhe "Gjergj Filipi", drejtim i detyruar majtas-djathtas;
- Në kryqëzimin e rrugës "Abdyl Frashëri" (sipas sensit Perëndim-Lindje) me bulevardin "Dëshmorët e Kombit", drejtim i detyruar drejt-majtas;
- Në kryqëzimin e rrugës në Sheshin "Italia" me rrugën "Lekë Dukagjini", drejtim i detyruar majtas.

Adresa: Sheshi "Skënderbej", nr.2, 1001, Tiranë, Shqipëri, tel.: +355 4 2226629, fax: +355 4 2228430

3. Itenerari i lëvizjes së mjeteve të linjës urbane "Tirana e Re" dhe linjës "Teg-Sauk i Vjetër-Kopshti Zoologjik – Ish-Stacioni Trenit" do të pezullohet në segmentin e bulevardit "Dëshmorët e Kombit" dhe sheshin "Nënë Tereza" duke devijuar në kryqëzimin e rrugës "Abdyl Frashëri" (sipas sensit Perëndim-Lindje) me bulevardin "Dëshmorët e Kombit", drejtim i detyruar majtas.

4. Për zbatimin e kësaj urdhërese ngarkohet, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike dhe Policia Bashkiake, në bashkëpunim me Komisariatin e Qarkullimit Rrugor.

Kjo urdhëresë hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Erion VELIAJ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA TIRANË